



STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR KUKA TECHNICS

THEMELIMI I SHOQERISE

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar KUKA TECHNICS sh.p.k. eshte themeluar me aktin e themelimit te dates 29.07.2021.

EMERTIMI

Neni 2

Emertimi i tregetar i Shoqerise eshte KUKA TECHNICS sh.p.k.
Inicialet SHPK jane te nevojshme te perdoren ne logo ose per qellime reklame.

SELIA

Neni 3

Selia e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar KUKA TECHNICS sh.p.k eshte ne Shkoder Zona Industriale, Godina me numer pasurie me Nr 14/210, z.k.8593, Shkoder.
Ajo do te hape filiale dhe ne rrethe te tjera brenda dhe jashte vendit.

KOHEZGJATJA

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e shoqerise eshte e pakufizuar ne kohe.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 5

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise KUKA TECHNICS sh.p.k. eshte:

- Ne fushen e prodhimit te dymere dhe dritarev te Duroaluminit dhe PVC si dhe tregtimin e tyre.
- Ne fushen e import-eksportit te materialeve dhe makinerive te ndryshme
- Ne fushen e ndertimeve civile dhe industriale, per vete dhe per te tjeret.
- Ne fushen e tregtise me shumice e pakice, import -eksport i tyre
- si dhe çdo aktivitet te lejuar me ligj.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali themelor i shoqerise eshte ne masen 100'000,00 (njqindmije) leke, ose dy kuota te ndara si me poshte:

- | | | | |
|----------------------------|------|-------------|--------------------------------|
| 1- Znj. Alma Uruçi | 25 % | ose 1 kuota | ne vlere leku 25'000,00 leke. |
| 2- Z. Koen Frieda R Bynens | 75 % | ose 1 kuota | ne vlere leku 75'000,00 leke . |

TRANSFERIMI I KUOTAVE TE KAPITALIT

Neni 7

1-Ne rastin e transferimit te kuotave te kapitalit, ortaku qe kerkon te shese kuotat e tij te kapitalit duhet te njoftoje me shkrim administratorin i cili njofton menjehere Asamblene e ortakeve per cmimin e shitjes se kuotave te ortakut qe kerkon ti shese.

2-Çmimi i kuotave oferte per shitje duhet te vendoset ne baze te vleres reale te Shoqerise ne momentin e dhenies se te drejtes. Ortaket e tjere mund ti blejne ne raport me kuotat ekzistuese duke ruajtur nje njejtat raporte me kuotat qe posedojne secili .

3- Ne qofte se brenga 30 diteve nga komunikimi i ofertes per shitje te kuotave te kapitalit te shoqerise asnjeri nga ortaket e shoqerise nuk shprehet per blerjen e tyre atehere Kuotat oferte shitje mund ti transferohen cdo personi qe kerkon ti bleje.

TRANSFERIMI TEK PJESETARI I FAMILJES

Neni 8

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme mes bashkeshorteve si dhe mes paraardhesve dhe pasardhesve. Transferimi i pjeses se kapitalit mes bashkeshortesh ne rast ndarjeje pasurie gjithashtu nuk kufizohet.

TRANSFERIMI I PJESES SE KAPITALIT NE RRUGE TRASHEGIMIE

Neni 9

Pjeset e kapitalit jane te trashegueshme. Ne rast se trashegimtari nuk e aplikon te drejten per te marre pjese ne shoqeri Brenda nje muaji nga perfundimi i procesit te ndarjes se trashegimise atehere atij nuk i takon pjesa e kapitalit, por pjesa e ortakut te perjashtuar, vlere e te cilit percaktohet me vendim te asamblese se ortakeve. Pagesa e pjeses se ortakut te perjashtuar behet pa vonesa te teperta, po jo me vone se 30 dite nga dita e transferimit te pjeses se kapitalit tek nje nga ortaket ose tek nje person i trete, ose nga dita e zvogelimit te kapitalit themeltar si pasoje e zbritjes se kontributit te ortakut te vdekur, ose nga dita kur ortaket e tjere e ndajne kontributin e ortakut te vdekur ne raport me pjeset e tyre te kapitalit.

FORMA E TRANSFERIMIT TE PJESEVE TE KAPITALIT

Neni 10

Kontrata per transferimin e pjeses se kapitalit duhet te jete ne formen e aktit noterial dhe ne rast se pronari i ri nuk eshte ortak i shoqerise, duhet te deklarroje shprehimisht ne kontrate se eshte njohur me aktin e themelimit te shoqerise dhe statutine shoqerise dhe se eshte dakort me aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise.

RRITJA E KAPITALIT THEMELOR

Neni 11

Kapitali themelor mund te rritet pa kufizim ne cdo moment dhe nje ose disa here me votim te Asamblese e Ortakeve votues present apo perfaqesues qe permbajne mbi 3/4 e kapitalit themelor. Ne rastin e shqyrtimit te rritjes se kapitalit, te gjithë ortaket kane te drejten te nenshkruajne rritjen sipas kuotave qe posedojne, ne rast se nuk e ushtrojne kete te drejte, kuotat e tyre mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere ne menyre proporcionale sipas pjesemarrjeve perkatese.

REDUKTIMI KAPITALIT THEMELTAR

Neni 12

1-Kapitali themeltar mund te reduktohet me Vendim te Asamblese te Ortakeve, me votim te ortakeve prezente apo perfaqesuesve qe perfaqesojne mbi 3/4 e kapitalit te shoqerise.

2-Reduktimi i kapitalit te shoqerise perballohet nga secili ortak ne menyre proporcionale sipas kuotave qe zoterojne. Asamblea mund te vendose reduktimin e kapitalit te shoqerise brenda limiteve te ligjit, qofte edhe nepermjet ortakeve te veten apo grupe ortakesh, aktivitetesh te shoqerise apo aksioneve ose kuotave te shoqerive te tjera ne te cilat shoqeria ben pjese.

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 13

1.Ortaku ka te drejte te informohet lidhur me administrimin e shoqerise, te njihet me bilancin vjetor dhe te kerkoje me shkrim sqarime te cilat i jep administratori i mbledhjen e asamblese.

2.Secili nga ortakët ka te drejte t'i kerkoje gjykates qe te heqe nga funksioni administratorin i cili ka shkelur ligjin.

3.Secili ortak qe nuk eshte administrator, ka te drejte ti paraqese me shkrim dy here ne vit administratorit pyetjet lidhur me problemet, egzistenca e te cilave ve ne dyshim vazhdimesin e aktivitetit te shoqerise. Lidhur me pergjigjen e administratorit vihen ne dijeni edhe eksperti kontabel i autorizuar.

4.Ne rast se shoqeria nuk ka ekspert kontabel te autorizuar, atehere emerimi i nje eksperti kontabel te autorizuar mund te kerkohet ne rruge gjyqesore nga nje ose disa ortake, pjeset e kapitalit te te cileve perfaqesojne te pakten 1/10 e kapitalit themeltar.

5.Nje ose disa ortake, pjeset e kapitalit te te cileve se bashku perfaqesojne 1/10 e kapitalit themeletar, mund te kerkojne ne rruge gjyqesore caktimin e nje ose disa eksperteve te ngarkuar per paraqitjen e nje raporti per nje apo disa veprimtari administrative. Raporti i ekspertit i dorezohet ortakut/ortakeve qe ka bere kerkesen, administratorit, eventualisht eksperteve kontabel te autorizuar, ne qofte se jane emeruar, raporti paraqitet ne mbedhjen e ardhshme te asamblese.

6.Ortaku nuk mund te marrre hua nga shoqeria, te miratoje ne emer te shoqerise paradheniet ose te behet garant per detyrimet ndaj personave te trete. Ne rast te kundert veprimi eshte i pavlefshem, kjo vlen edhe per perfaqesuesit ligjore te tij, bashkeshortin si dhe per paraardhesit e pasardhesit e tij.

7.Ortaku, qe eshte person juridik, eshte i detyruar qe menjehere te njoftoje ortakët e tjere lidhur me ndryshimet e sattutit ose te perberjes se organeve te tij.

PERFAQESIMI I SHOQERISE

Neni 14

1-Asamblea e Ortakeve

2-Administratori

ASAMBLEA

Neni 15

Organi vendimor i shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve. Vendimet e saj me shumice pengojne ortaket qe mungojne apo te papajtueshem, pervec rasteve te te drejtes se tyre te kundershimit te ushtruar ne raste, afate apo forma te parashikuara ne ligj.



KOMPETENCAT E ASAMBLESE

Neni 16

Asamblea eshte organi me i larte vendimor i shoqerise i cili vendos per :

- Mosmiratimin e veprimeve te ortakeve themelues perpara rregjistrimit te shoqerise.
- Miratimin e bilancit vjetor, ndarjen e fitimit dhe menyren e ndarjes se humbjeve te shoqerise.
- Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themelor.
- Ndryshimin e aktit themelues ose statutit.
- Emerimin, heqjen dhe shperblimin e administratorit dhe te ekspertit kontabel te autorizuar.
- Prishjen e shoqerise
- Çështje te tjera te cilat ky statut i le ne komptentece te tij.

MBLEDHJA E ASAMBLESE DHE VOTIMI

Neni 17

1.Asamblene e therret administratori, eventualisht eksperti kontabel i autorizuar ose likuidatori: Asamblea Ortakeve duhet te mblidhet te pakten nje here ne vit brenda 6 muajve nga dita e mbylljes se bilancit te vitit ushtrimor. Te gjithë ortaket duhet te lajmërohen me leter rekomande dhe ftesa duhet tju dorezohet te pakten 15 dite perpara mbledhjes se asamblese. Ftesa duhet te permbaje rendin e dites se mbledhjes se asamblese.

2.Administratori, eksperti kontabel, likuidatori ose ortaket pjesat e te cileve te kapitalit perbejne te pakten 10% te kapitalit themeltar te shoqerise mund te kerkojne mbledhjen e asamblese kurdo qe e quajne te aresyeshme.

3.Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne asamble dhe te beje present opinionin e tij. Numri i votave te çdo ortaku ne asamble i pergjigjet pjeses se tij ne kapitalin themelor te shoqerise.

4.Ortaku mund te perfaqesohet ne mbledhjen e asamblese nga nje ortak tjetër ose nga nje person i trete ne baze te autorizimit firma e te cilit vertetohet nga noteri. Ortaku nuk mund te ngarkoje mandatmbajtesin qe te votoje ne emer te nje pjese te kapitalit te tij themeltar, duke votuar ai vete ne emer te pjeses tjetër te kapitalit themeltar.

5.Asamblea e Ortakeve mund te marre vendime vetem ne rast se jane te pranishem ortaket, pjeset e te cileve te kapitalit perfaqesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise.

6.Ortaket mund te marrin vendime edhe pas konsultimit me shkrim , ne rast se te gjithë ortaket miratojne me shkrim permbajtjen e konsultimit. Ne rast propozimi i vendimit te shoqerise i dorezohet te gjithë ortakeve me qellim qe te japin mendimin e tyre. Ne propozim shenohet afati brenda te cilit ortaket duhet te shprehen me shkrim lidhur me propozimin.

7. Vendimet ne mbledhjen e asamblese ose pas konsultimit me shkrim merren nga nje ose disa ortakë qe perfaqesojne me shume se tre te katertat e kapitalit themelor. Ky numer votash mjafton edhe per ndryshimin e statutit te shoqerise.

ADMINISTRATORI

Neni 18

Shoqeria perfaqesohet nga administratori.

Ne emer te shoqerise firmos administratori i cili i bashkangjit emertimin tregtar te shoqerise emrin, mbiemrin dhe funksionin e tij.

EMERIMI I ADMINISTRATORIT

Neni 19

Administratori i Shoqerise KUKA TECHNICS sh.p.k. emerohet nga asambleja e Ortakeve me shumicen e votave te ortakeve, pjeset e te cilave perfaqesojne mbi 50% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise, administratori mund te jete ortak ne shoqeri ose jo.

Administratori Koen Fruieda R Bynens emerohet per nje afat 5 vjeçar me te drejte perseritje.

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Neni 20

1. Administratori ka te drejte te veproje ne emer te shoqerise ne marredhenie me persona te trete persa i perket te gjitha ceshtjeve me perjashtim te atyre qe ligji ose ky statut i le ne kompetence te Asamblese.

2. Administratori eshte i detyruar te kerkoje miratimin paraprak te Asamblese se Ortakeve per te gjitha kontratat e diskutuara prej tij dhe te treteve.

3. Administratori ka per detyre ne kuadrin e kompetencave te tij te siguroje mbajtjen e rregullt te evidences dhe llogarise sipas ligjit, te mbaje listen e te gjitha ortakeve dhe te informoje ortakët lidhur me ceshtjet qe i takojne shoqerise.

4. Administratori ka per detyre te ngreje stafin drejtues dhe te pajtoje punemarres ne shoqeri ne funksionet qe ai i sheh te arësyeshme dhe nenshkruan kontratat e punes me punemarresit.

DETYRAT E ADMINISTRATORIT

Neni 21

1. Administratori i shoqerise ka detyre te kryeje funksionin e tij me kujdesin e duhur dhe te ruaje sekretin lidhur me informacionet dhe faktet konfidenciale, transmetimi i te cilave te persona te trete mund te shkaktoje deme per shoqerine. Detyrimi per te ruajtur sekretin vazhdon edhe mbas perfundimit te funksionit te administratorit.

2. Administratori pergjigjet per demin, te cilin e shkakton nga veprimet e kryera prej tij ne dem te shoqerise.

3. Administratori nuk mund te marre hua nga shoqeria, te miratoje ne emer te shoqerise paradheniet ose te behet garant per detyrimet ndaj personave te trete. Ne rast te kundert veprimi eshte i pavlefshem, kjo vlen edhe per perfaqesuesit e tij ligjore, bashkeshortin si dhe per paraardhesit apo pasardhesit e tij.

4. Administratori ka detyrë që të paken një herë në vit t'i paraqesë asamblese raportin mbi aktivitetin e shoqërisë dhe gjendjen e pasurisë së tij.

5. Administratori përfaqëson dhe i paraqet asamblese raportin lidhur me marrëveshjen mes atij ose një ortakut dhe shoqërisë. Ortaku që është pale e marrëveshjes nuk mund të votojë në mbledhjen e asamblese. Administratori ose ortakut që nënshkruajnë një marrëveshje pa miratimin e asamblese, i përgjigjen shoqërisë për dëmin e shkaktuar si pasojë e kësaj marrëveshjeje.

USHTRIMI VETOR I SHOQËRISË , BILANCI VJETOR, NDARJA E FITIMIT

Neni 22

1- Viti ushtrimor i aktivitetit të shoqërisë mbyllet me datën 31 dhjetor. Në fund të vitit ushtrimor administratori procedon me hartimin e bilancit me llogaritjen e fitimit dhe humbjes sipas normave të ligjit, duke e shoqëruar me një relacion shtesë për aktivitetin e shoqërisë.

2- Çdo ortak ka të drejtë të ketë nga Administratori lajmë mbi zhvillimin e punëve të shoqërisë dhe të konsultohet me librat e shoqërisë.

NDARJA E FITIMIT

Neni 23

Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor, reduktuar me 5%(pesë përqind) të destinuar për rezervën ligjore, që arrijnë deri në 10% të kapitalit të shoqërisë, si edhe reduktimet eventuale të përcaktuara nga Asambleja, shpërndahen ndërmjet ortakëve në raport me kuotat e kapitalit që zoteron secili.

TRANSFORMIMI I SHOQËRISË

Neni 24

Shoqëria me Përgjegjësi të kufizuar mund të kthehet në shoqëri kolektive apo komandite vetëm me aprovim unanimit të ortakëve dhe mund të transformohet në shoqëri aksionere me aprovim të shumicës së ortakëve që zoterojnë mbi 50% të kuotave të kapitalit.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 25

Te gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë nga interpretimi, zbatimi dhe zgjidhja e Aktit të Themelimit dhe Statutit të shoqërisë si dhe në përgjithësi të gjitha mosmarrëveshjet e ortakëve, apo midis një ortakut dhe shoqërisë në parim do të zgjidhen me mirekuptim dhe në bazë të aktit të themelimit dhe statuti, në rast mungese të mirekuptimit zgjidhja i besohet Gjykatës Shqiptare kompetente.

SHKRIRJA E SHOQËRISË

Neni 26

Shoqëria shkrihet :

- ditën e shënuar në Vendimin e Asamblese për shkrirjen e shoqërisë.
- ditën e shënuar në vendimin e gjykatës për shkrirjen e shoqërisë
- në rast të tjera, të cilat vendosen me ligj.

GJUHA

Neni 27

Ky statut është redaktuar në Lezhë me datë 29.07.2021 në katër kopje origjinale në Gjuhën Shqipe dhe nuk ka asnjë version tjetër nga asnjëri nga ortakët.



DISPOZITA TE FUNDIT
NENI 28

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut eshte kompetence e Asamblese se Ortakeve qe te beje plotesimin e dispozitave te ketij statuti, si dhe shfuqizimin e atyre dispozitave te cilat behen te pavlefshem dhe jo-efektive dhe keto ndryshime do te behen ne formen e nje dokumenti noterial.

ORTAKET THEMELUES


Alma Uruçi

Alma Uruçi

Koen Frieda R Bynens

KOEN FRIEDA R. BYNENS

Edlira Marku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE SHKODËR

NOTER VASIL MARTINI
ADRESA Rr. Luigj Gurakuqi, Nr 2 ,
Lezhe
TEL: 0682049692

VËRTETIM I NËNSHKRIMIT NË AKTET E SHOQËRIVE TREGTARE

Nr. repertori: 3582

Lezhe më 29/07/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2021043370166939271

NOTER
LEZHË

**AKT-THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
KUKA TECHNICS**

FORMIMI

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar KUKA TECHNICS Sh.p.k. sot me daten 29.07.2021 nga ortakët themelues:

- 1- **Alma Uruçi** me atesi Sami dhe amesi Lumnie, e datelindjes 28.01.1979 lindur ne Shkoder dhe me banim ne Bruksel, Parkstraatr 117/02 Bush, 1800 Vilvoorde, Belgjike madhor me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me leternjoftim me Nr personal H95128033H
- 2- **Koen Frieda R Bynens** me atesi Giudo Bynens dhe amesi Maryse Willems, lindur me 01.05.1971 dhe me banim ne Holt 100 Bus 1, 3740 Bilzen, Belgjike, madhor me zotesi te plote per te vepruar i identifikuar me leternjoftim me nr 595-0073204-84.

S E L I A

Selia e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar KUKA TECHNICS sh.p.k eshte ne Shkoder Zona Industriale, Godina me numer pasurie me Nr 14/210 z.k.8593, Shkoder. Ajo do te hape filiale dhe ne rrethe te tjera brenda dhe jashte vendit.

FORMA JURDIKE

Forma juridike e shoqerise eshte Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar.

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e shoqerise eshte e pakufizuar ne kohe.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise KUKA TECHNICS sh.p.k. është:

- Ne fushen e prodhimit te dyerve dhe dritarev te Duroaluminit dhe PVC si dhe tregtimin e tyre.
- Ne fushen e import-eksportit te materialeve dhe makinerive te ndryshme
- Ne fushen e ndertimeve civile dhe industriale, per vete dhe per te tjeret.
- Ne fushen e tregtise me shumice e pakice, import –eksport i tyre
- si dhe cdo aktivitet te lejuar me ligj.

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themelor i shoqerise eshte ne masen 100'000,00 (njqindmije) leke, ose dy kuota te ndara si me poshte:

KONTRIBUTI I ORTAKEVE

- 1- Znj. Alma Uruçi , 25 % ose 1 kuota ne vlere leku 25'000,00 leke.

2- Z. Koen Frieda R Bynens 75 % ose 1 kuota ne vlere leku 75'000,00 leke .



ORGANET DREJTUESE

Asambleja e ortakëve është organi më i lartë vendimor i shoqërisë. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në asamble dhe të bëjë prezent opinionin e tij. Numri i votave të çdo ortaku është në raport me pjesën e tij të kapitalit në kapitalin themelor të shoqërisë.

Shoqëria tregtare KUKA TECHNICS sh.p.k. drejtohet nga administratori Koen Frieda R Bynens i cili emërohet nga asambleja e ortakëve për një afat 5-vjeçar me të drejtë perseritjeje i cili ka të drejtë që sipas rastit të emërojë të gjithë punonjësit e shoqërisë.

Në mardhëniet me të tretet Shoqëria përfaqësohet nga administratori.


Në emër të shoqërisë firmos administratori i cili i bashkëngjitet emërtimin tregëtar të shoqërisë emrin, mbiemrin dhe funksionin e tij.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues.

ORTAKET THEMELUES

Alma Uruçi

Koen Frieda R Bynens


Alma Uruçi


KOEN FRIEDA R. BYNENS.